

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6822  
E premte, 10 shkurt 2023  
çmimi 0.40 €

## Mbi 19 300 viktima nga tërmetet në Turqi dhe Siri

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KUVENDI I KOSOVËS MBAN SEANCË PLENARE, KURTI NUK U SHPËTON KRITIKAVE TË OPOZITËS NË LIDHJE ME DIALOGUN KOSOVË - SERBI

FAQE 4-5

# OPOZITA KËRKON TRANSPARENCË NGA KURTI PËR DOKUMENTIN FRANKO-GJERMAN



Deputetët opozitarë kanë kritikuar të enjten kryeministrin Albin Kurti për mostransparencë lidhur propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në seancën e plenare të

Kuvendit, opozita ka theksuar se nuk është e njoftuar mbi përmbajtjen e saktë të draftit të dokumentit franko-gjerman, duke kërkuar nga Kurti të jetë transparent në këtë çështje. Kryeministri Kurti ka thënë se është i

hapur për të diskutuar për të gjitha gjërat që lidhen me propozimin e BE-së, duke potencuar se për këtë ose duhet takim ose raportim në Kuvendin e Kosovës, por me dyer të mbyllura

## AKTUALE



**TËRMETI NË TURQI, MPJD: SHTETASIT E KOSOVËS ME TË CILËT ËSHTË VËNË KONTAKT JANË JASHTË RREZIKUT** F. 7

**KOMUNA E SKENDERAJT TREGON VLERËN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET** F. 6

**MOLLIQAJ VIZITON KRERËT E UÇK-SË NË HAGË: EMRI I UÇK-SË NUK MUND TË JETË NËN AKUZË** F. 6

## EKONOMI



**FIRMOSET MARRËVESHJA 38 MILIONË EUROSHE PËR REHABILITIMIN E RRJETIT HEKURUDHOR NË KOSOVË** F. 8

**MIRATOHET NË LEXIM TË DYTË PROJEKTILIGJI PËR BYRONË SHTETËRORE** F. 8

## SPORT



**KB PEJA LARGON KATËR BASKETBOLLISTË, TRANSFERON DY** F. 10

**PE-ja U BËNË THIRRJE KOSOVËS DHE SERBISË TË AVANCOJNË NË PROCESIN E DIALOGUT** F. 3



**BORRELLI PRET QË KURTI DHE VUÇIQI TË TAKOHEN "SË SHPEJTI" PËR MBËSHTETJE TË PROPOZIMIT** F. 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Mbi 19 300 viktima nga tërmetet në Turqi dhe Siri

ANKARA, 9 SHKURT - Mbi 19 300 persona kanë humbur jetën si pasojë e tërmeteve të fuqishme të 6 shkurtit në Turqi dhe Siri teksa shpresat për të nxjerrë të mbijetuar nga gërmadhat e ndërtesave të rrënuara po zbehen për çdo orë që kalon. Në Turqi më shumë se 16 170 njerëz kanë humbur jetën dhe mbi 60 000 janë lënduar, sipas Agjencisë së Menaxhimit të Fatkeqësive. Në Siri janë raportuar më shumë se 3 200 viktima. Tërmeti i parë i 6 shkurtit ishte 7.8 ballësh me epiqendër rreth 26 kilometra nga qyteti Nurdagi dhe rreth 33 kilometra larg qytetit Gaziantep, tha Shërbimi Gjeologjik amerikan. Po ashtu, gjatë po asaj dite u regjistrua një tërmet tjetër i fuqishëm prej 7.5-shkallësh të Rihterit. Gjatë natës ekipet e shpëtimit vazhduan të kërkojnë për të mbijetuar mes rrënojave të strukturave të shembura, por

shpresat për të gjetur më shumë njerëz të gjallë shkojnë duke u zvogëluar pasi kanë kaluar më shumë se tri ditë që nga tërmetet. Përpjekjet për shpëtim janë penguar nga temperaturat e ulëta dhe qindra pasgoditje të cilat e kanë bërë veçanërisht të rrezikshme punën në strukturat e paqëndrueshme. Dhjetëra mijëra njerëz kanë humbur shtëpitë e tyre. Ekspertët thanë se koha po mbaron për të mbijetuarit e bllokuar nën rrënojat e tërmeteve në Turqi dhe Siri teksa përpjekjet e kërkim-shpëtimit janë vendimtare në 72 orët e para. Më shumë se 90 për qind e të mbijetuarve të tërmetit shpëtohen brenda tri ditëve të para, thanë ata. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, vizitoi të mërkurën provincën e Hatait, e cila është goditur rëndë, prej ku banorët kanë kritikuar përpjekjet e qeverisë, duke thënë se ekipet e



kërkim-shpëtimit shkuan me vonesë. Sipas Agjencisë së Menaxhimit të Fatkeqësive, më shumë se 110

000 trupa të ekipeve të shpëtimit po marrin pjesë në operacionet për të shpëtuar sa më shumë jetë dhe më shumë se 5 500

automjete, përfshirë traktorë, vinça, buldozerë dhe ekskavatorë, janë dërguar në zonat e prekura nga tërmetet.

## Zelensky në Bruksel kërkon më shumë armë për t'u mbrojtur nga Rusia 'anti-evropiane'

BRUKSEL, 9 SHKURT - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka mbërritur në Bruksel për të vazhduar lobimin për armë më të avancuara nga aleatët evropianë, duke i thënë Parlamentit Evropian se vendi i tij po lufton "kundër forcës më të madhe anti-evropiane të botës moderne". Vizita e 9 shkurtit në Bruksel ishte e fundit në turneun e papritur të Zelenskyt në Evropë, prej ku ai kërkoi më shumë armë, pas pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Rusia, dhe erdhi pasi forcat ruse thuhet se shtuan sulmet në lindje të Ukrainës përpara një ofensive të pritshme në prag të përvjetorit të luftës. Edhe pse Zelensky nuk ka gjasa të largohet nga Brukseli me premtime të menjëhershme për më shumë ndihmë ushtarake, vizita do t'i japë atij mundësinë për të folur me të 27 udhëheqësit e Bashkimit Evropian gjatë një samiti të planifikuar më vonë gjatë ditës. Gjatë fjalimit të tij në Parlamentin



Evropian presidenti ukrainas falënderoi BE-në për ndihmën që blloku ka dhënë qëkur Rusia filloi fushatën agresive të pushtimit të vendit të tij. "Faleminderit", tha Zelensky teksa ligjvënësit e BE-së duartrokiten gjatë. "Ne po mbrohemi në fushëbetë, ne

ukrainasit, së bashku me ju ... kundër forcës më të madhe anti-evropiane të botës moderne", tha ai. Javët e fundit Ukraina ka marrë premtime nga vendet perëndimore se do t'i sigurojnë tanke luftarake, por ka bërë thirrje

për armatim edhe më të avancuar, duke përfshirë avionë luftarakë dhe raketa me reze më të gjatë. Zelensky pritet, gjithashtu, ta adresojë nevojën për fillim të shpejtë të bisedimeve për anëtarësim në BE gjatë samitit. "Ukraina do të jetë pjesë e

Bashkimit Evropian, një Ukrainë fitimtare", tha Zelensky në Parlamentin Evropian. Kryetarja e Parlamentit të BE-së, Roberta Metsola, teksa iu drejtua Zelenskyt, tha se "ju duhet të fitoni dhe tani vendet anëtare të BE-së duhet ta konsiderojnë hapin e ardhshëm të shpejtë, sigurimin e sistemeve me reze të gjata dhe avionëve që ju nevojiten për ta mbrojtur lirinë tuaj". Gjatë vizitës së tij në Parlamentin britanik më 8 janar, Zelensky u bëri thirrje në mënyrë specifike liderëve perëndimorë që të siguronin avionë luftarakë. Presidenti ukrainas filloi një turne të papritur në Evropë më 8 shkurt, me vizita në Britani dhe Francë, duke shënuar udhëtimin e tij të dytë jashtë vendit që nga pushtimi rus, pothuajse një vit më parë. Pas vizitës në Britani, presidenti ukrainas u nis për në Paris për darkë me presidentin francez Emmanuel Macron dhe kancelarin gjerman Olaf Scholz.

## Rusia sanksionon 77 zyrtarë amerikanë

MOSKË, 9 SHKURT - Rusia ka sanksionuar dhjetëra politikanë dhe zyrtarë amerikanë të mërkurën, në atë që tha se ishte një veprim hakmarrës për mbështetjen e Uashingtonit për Kievin, dhe një përgjigje ndaj sanksioneve të Perëndimit kundër Moskës. Ministria e Jashtme ruse tha se ua ka ndaluar përgjithmonë hyrjen në Rusi 77 shtetasve

amerikanë. Lista përbëhet nga 33 guvernatorët e shteteve të ShBA-së dhe një mori zyrtarësh të tjerë shtetërorë dhe federalë të rangut të mesëm. Sanksionet e ShBA-së, BE-së dhe vendeve të tjera kundër Rusisë kanë shkuar vazhdimisht duke u rritur. Sot janë në fuqi një varg sosh - nga ndalimi i mallrave dhe

shërbimeve ruse deri te bllokimi i transaksioneve të saj financiare. Dhjetëra kompani ndërkombëtare, po ashtu, kanë pezulluar tregtinë në Rusi, ose janë tërhequr fare. Nga disa media në ShBA sanksionet janë cilësuar si më të rëndat dhe më të koordinuarat ndonjëherë nga Perëndimi. Pushtimi rus i Ukrainës ka nisur më 24 shkurt.





# PE-ja u bënë thirrje Kosovës dhe Serbisë të avancojnë në procesin e dialogut

Në debatin e zhvilluar në Komisionin e Parlamentit Evropian për Politikë të Jashtme është diskutuar lidhur me raportet për Kosovën dhe Serbinë. Këto dy raporte janë hartuar nga raportuesit për këto dy vende: Viola Von Cramon për Kosovën dhe Vladimir Bilçik për Serbinë. Parlamenti Evropian përsëriti thirrjen që të dyja vendet të avancojnë në procesin e dialogut. Po ashtu, edhe kësaj radhe u bë thirrje për njohjen e Kosovës si shtet sovran nga pesë vendet e Bashkimit Evropian që ende nuk e kanë bërë një hap të tillë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**BRUKSEL, 9 SHKURT** - Komisioni i Parlamentit Evropian për Politikë të Jashtme u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë të avancojnë në procesin e dialogut që ndërmjetëson Brukseli. Këto komente janë bërë në një debat që është zhvilluar në këtë komision lidhur me raportet për Kosovën dhe Serbinë. Këto dy raporte janë hartuar nga raportuesit për këto dy vende: Viola Von Cramon për Kosovën dhe Vladimir Bilçik për Serbinë. Raportuesja për Kosovën, Viola von Cramon, ka thënë se "Kosova ka bërë një rrugë të madhe drejt demokracisë" dhe ka shtuar se, "përkundër polarizimit politik që ekziston kohën e fundit në Kosovë, ky vend ka ecur para disa vendeve të rajonit në arritjen e standardeve të demokracisë". Megjithatë, ajo ka thënë se duhet arritur më shumë përparim në fushën e gjyqësorit, në mënyrë që të zhduket ndikimi i panevojshëm politik.

Sa i përket aplikimit të Kosovës për anëtarësim në BE, von Cramon ka deklaruar se kjo çështje varet nga reformat e brendshme, por edhe nga dialogu me Serbinë. "Ky dialog kërkon udhëheqësi dhe përkushtim të qartë dhe nuk duam që Kosova të shihet si palë që është më pak konstruktive në dialog", ka thënë Von Cramon. Ajo ka tërhequr vërejtjen se situata e sigurisë në veri të Kosovës është edhe përgjegjësi e BE-së. "Ndoshta duhet të forcojmë edhe praninë e EULEX-it në veri. Po ashtu, duhet të shohim se cilin rol duhet të luajmë në dialog", ka thënë mes tjerash ajo. Deputeti austriak nga radhët e grupit të Partisë Popullore Evropiane, Lukas Mandle, ka thënë në fjalimin e tij se sa iu përket vlerave dhe orientimit evropian, "Kosova është para të tjerëve si me vlera, me demokraci, po ashtu me shoqërinë civile". Propozimin e BE-së për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë ky



deputet e ka quajtur si "një njohje de facto, dhe diçka që është vonuar". Në debatin për Serbinë shumë deputetë kanë përsëritur kritikën për mungesën e përparimit në përshtatjen e politikave të këtij shteti me ato të BE-së për sanksionimin e Rusisë pas nisjes së luftës në Ukrainë në shkurt të vitit të kaluar. Mes të tjerash, në draftin e raportit të hartuar nga Viola von Cramon, "mirëpritet marrëveshja e shumëpritur për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës". Sipas planit, liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të nisë më 1 nëntor të këtij viti, nëse deri atëherë hyn në funksion sistemi elektronik i BE-së për autorizimin e udhëtimeve, i njohur me shkurtesën ETIAS, ose jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024.

Parlamenti Evropian përsëriti edhe kësaj radhe thirrjen për njohjen e Kosovës si shtet sovran nga pesë vendet e Bashkimit Evropian që akoma nuk e kanë bërë një hap të tillë. Në tekst bëhet thirrje edhe për një angazhim të sigurt të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve të serbëve të Kosovës për një dialog i cili "do ta forconte besimin e ndërsjellë". Po ashtu, bëhet thirrje edhe për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tash në dialog, përfshirë edhe atë për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Parlamenti Evropian përsëriti përshtatjen e Kosovës me qëndrimet e BE-së në politikën e jashtme dhe të sigurisë, sidomos dënimin e ashpër të agresionit të

Rusisë ndaj Ukrainës dhe zbatimin e sanksioneve ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë. Serbisë i bëhet thirrje që t'i mbështesë këto qëndrime për të dëshmuar se është e orientuar drejt integritetit në BE. Në veçanti, raporti përmend edhe hapësirën që Serbia u jep disa medieve nga Rusia, për të funksionuar dhe për ta shtrirë propagandën ruse. Në Parlamentin Evropian ka propozime edhe për kushtëzimin e vazhdimet të negociatave të anëtarësimit të Serbisë me BE-në me mbështetjen e sanksioneve ndaj Rusisë. Deputetët e Parlamentit Evropian do të kenë mundësi deri më 15 shkurt t'i dorëzojnë amendamentet e tyre për këto raporte dhe më pas do të votohet për to dhe për raportin në tërësi.

## Kamberi: S'mund të ketë standarde të veçanta vetëm për pakicën 'hyjnore' në Kosovë



**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Përfaqësuesi i komunitetit shqiptar në jug të Serbisë, Shqipëri Kamberi, thotë se standardet që do të vendosen për komunitetin serb në Kosovë duhet të jenë standarde për të gjitha pakicat në Ballkanin Perëndimor. "Ne nuk mund të rrimë duarkryq dhe ta shikojmë krijimin e standardeve të veçanta që do të vlejnjë për një pakicë 'hyjnore' në veri të Kosovës", thotë Kamberi për "Radion Evropa e Lirë" duke iu referuar pakicës serbe. Fundjavën e kaluar Kamberi dhe disa përfaqësues të boshnjakëve që jetojnë në Serbi takuan në Prishtinë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Kërkesë e tyre e përbashkët ishte që pakicat në Serbi të gëzojnë të drejta të njëjta sikurse pakica serbe në Kosovë. Sipas një njoftimi të lëshuar nga kabineti i Kurtit, ata u shprehën të pakënaqur me pozitën e shqiptarëve dhe të

boshnjakëve në Serbi, sidomos në komunat: Novi Pazar, Tutin, Sjenicë, Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc. "Komunitetet e ndryshme duhet të trajtohen pa dallim në kuadër të parimeve universale dhe në përputhje të plotë me standardet e Bashkimit Evropian", tha Kurti. Aktualisht Kosova dhe Serbia janë në negociatë për normalizimin e marrëdhënieve. Kamberi, i cili është deputeti i vetëm shqiptar në Kuvendin e Serbisë, thotë se kërkesa themelore e shqiptarëve është që të kenë trajtim të barabartë në shtetin ku jetojnë. Si çështje problematike ai përmend "pjesëmarrjen joadekuate" të shqiptarëve në punën e institucioneve shtetërore dhe arsimimin. "Pesëmbëdhjetë breza të të rinjve shqiptarë përballen me mosnjohjen e diplomave [nga Kosova] dhe ata po ikin prej këtu", thotë Kamberi.





KUVENDI I KOSOVËS MBAN SEANCË PLENARE, KURTI NUK U SHPËTON KRITIKAVE TË OPOZITËS  
NË LIDHJE ME DIALOGUN KOSOVË - SERBI

## Opozita kërkon transparencë nga Kurti për dokumentin franko-gjerman

Deputetët opozitarë kanë kritikuar të enjten kryeministrin Albin Kurti për mostransparencë lidhur propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në seancën e plenare të Kuvendit, opozita ka theksuar se nuk është e njoftuar mbi përmbajtjen e saktë të draftit të dokumentit franko-gjerman, duke kërkuar nga Kurti të jetë transparent në këtë çështje. Kryeministri Kurti ka thënë se është i hapur për të diskutuar për të gjitha gjërat që lidhen me propozimin e BE-së, duke potencuar se për këtë ose duhet takim ose raportim në Kuvendin e Kosovës, por me dyer të mbyllura

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 SHKURT - Partitë politike opozitare në seancën e së enjtes të Kuvendit të Kosovës kanë ngritur një varg kritikash në drejtim të kryeministrit Albin Kurti lidhur me propozimin e BE-së për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se në dy takime lidhur me dialogun Kosovë - Serbi që kishte zhvilluar me kryeministrin Albin Kurti, i janë dorëzuar dy dokumente të ndryshme. Dokumenti i parë parashihte njohjen reciproke me Serbinë, ndërkaq dokumenti tjetër nuk përmbante marrëveshjen

finale dhe, sipas Abdixhikut, "ishite larg dokumentit që i kishte propozuar Kurti në takimin e parë".

Ai e ka pyetur kryeministrin për ta kuptuar se "çfarë ka nënshkruar dhe se në marrëveshjen e pranuar në parim a bëhet fjalë për marrëveshje përfundimtare ligjrisht të obligueshme apo për marrëveshje bazë". "As unë, as LDK-ja dhe asnjë parti tjetër në Kuvendin e Kosovës nuk jemi në dijeni mbi përmbajtjen e saktë të draftit të dokumentit në fjalë (propozimi franko-gjerman), sepse as unë e asnjë parti tjetër nuk ka qenë pjesë e negociatave dhe nuk ka qenë e informuar asnjëherë për këtë proces dhe përfundimin e tij", ka thënë Abdixhiku.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, e ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti se qëndrimet rreth planit franko-gjerman po i mban të fshehura

dhe se nuk është transparent në këtë çështje. "Dialogu nuk është çështje private mes teje dhe Vuçiqit, por është çështje shtetërore në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Krasniqi. Ai ka theksuar se për PDK-në mjafton që kryeministri ta ushtrojë përgjegjësinë konkrete, ligjore dhe kushtetuese, të dialogojë dhe ta arrijë marrëveshjen që e respekton identitetin dhe sovranitetin shtetëror e kushtetues të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq kryeministri Kurti ka thënë se është i hapur për të diskutuar për të gjitha gjërat që lidhen me propozimin e BE-së. Ai ka potencuar se për këtë ose duhet takim ose raportim në Kuvendin e Kosovës, por me dyer të mbyllura. "Procesi i dialogut duhet të jetë transparent, por konfidencialiteti i bisedimeve të jetë aty. Nëse unë e thërras një seancë të Kuvendit ku flasim për detajet e përmbajtjes kjo është me

shumë rrezik për Kosovën. Nëse e bëjmë me dyert e mbyllura dhe e thërret opozita është më lehtë", ka thënë ai.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Hardinaj, ka thënë se nuk duhet vënë faj kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, pasi që kjo çështje është e trashëguar nga qeveritë e mëparshme. Ai ka kërkuar nga deputetët që të tregohen të sinqertë në këtë drejtim. Ajo çka është me rëndësi për Kosovën dhe këtë proces, shtoi Hardinaj, është të dihet se si po e menaxhon qeveria dialogun me Serbinë. "Këtu mund të hyjmë në kritika dhe ka vend për shumë kritika, si për transparencë, si për menaxhim të situatës. Për mua dhe AAK-në është i pranueshëm propozimi franko-gjerman. I kërkoj kësaj qeverie, pranoje dhe mos u vono. Ta kthejmë juridiksionin në veri, t'i



# Borrelli pret që Kurti e Vuçiqi të takohen “së shpejti” për mbështetje të propozimit

PRISHTINË, 9 SHKURT - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, duke arritur në takimin e shefave të shteteve apo qeverive të BE-së, ka paralajmëruar se do t'i informojë liderët për ecurinë e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit dhe se çfarë është zhvilluar kohën e fundit. “Propozimi është në tavolinë. I kam ftuar dy liderët që të vijnë në Bruksel së shpejti, brenda disa javësh, në mënyrë që përfundimisht ta shtyjme përpara këtë propozim”, ka thënë Borrelli. Duke folur për samitin e BE-së, i cili zhvillon punimet të enjten dhe të premten në Bruksel, Borrelli ka thënë se do të kërkojë nga liderët e vendeve anëtare që të japin një mbështetje të fuqishme në mënyrë që të evitohet

përshkallëzimi dhe t'u kërkojnë që të punojnë seriozisht për këtë propozim, që është rruga e vetme për t'i zgjidhur problemet dhe normalizuar raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Kemi kaluar prej një krizë në tjetrën. Tash ka ardhur koha për deeskalim dhe për punë konstruktive”, ka thënë Borrelli.

Raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë do të jenë temë në samitin e shefave të shteteve apo qeverive të BE-së që është duke u zhvilluar të enjten e 9 shkurtit. Porosia për pritjet nga dialogu do të përfshihet edhe në konkluzat që do të miratohen në këtë samit. “Këshilli Evropian, në dritën e zhvillimeve të fundit në veri të Kosovës, nënvizon nevojën urgjente për progres në normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe

Serbisë përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja, të udhëhequr nga përfaqësuesi i lartë”, thuhet në draft. “Këshilli i BE-së mirëpret propozimin evropian për t'i vendosur raportet mes dy palëve në një bazë të re dhe të qëndrueshme si një rast historik i cili duhet të shfrytëzohet nga të dyja palët me qëllim të realizimit të perspektivës së tyre evropiane”, thuhet në propozimin e tekstit të konkluzave që do të miratohet në samitin dyditësh të shefave të shteteve të BE-së në Bruksel.

Në të njëjtin tekst liderët e vendeve anëtare do ta përsëritin edhe thirrjen për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura më herët. “Këshilli Evropian u bënë thirrje të dyja palëve që t'i implementojnë, në tërësi dhe pa kushte, obligimet të cilat i kanë

pranuar në kuadër të dialogut, përfshirë edhe marrëveshjet nga vitet 2013 dhe 2015 për ta krijuar Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe”, thuhet në pjesën e konkluzave.

Në BE presin që “së shpejti” të organizohet një takim në nivel të lartë në kuadër të dialogut ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, por ende nuk ka një datë për një takim të tillë.

Mbështetja për propozimin evropian për “marrëveshjen bazë” në mes të Kosovës dhe Serbisë që pritet të dalë nga ky samit, konsiderohet si sinjali më i fortë nga niveli më i lartë i BE-së për përkushtimin që kjo marrëveshje të arrihet.

Propozimi i BE-së për

normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi u është dorëzuar dy vendeve në fund të verës të vitit të kaluar, por përmbajtja e tij nuk është bërë publike.

Ky propozim, në të cilin ka pasur qasje REL-i, parasheh të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim të integritetit territorial, paprekshmëri të kufijve, njohje të simboleve shtetërore dhe një aranzhim të veçantë për komunitetin serb në Kosovë. Në dokument nuk përmendet njohja e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë apo anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara - për të cilat gjëra insistojnë publikisht zyrtarët kosovarë, por theksohet mbështetja që palët duhet t'i japin njëra-tjetrës në procesin e integritimeve evropiane.



mbajmë zgjedhjet në veri. Të nisemi drejt partneritet për paqe sa më shpejt sepse situatën e sigurisë në Ballkan nuk e kemi si duhet të jetë”, ka deklaruar Haradinaj.

Kryeministri Kurti më 6 shkurt ka thënë se e pranon propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë, “duke e konsideruar atë një bazë të mirë për diskutime të mëtejshme dhe një platformë solide për të ecur përpara”.

Në fjalën e tij në Kuvend, Kurti ka thënë se propozimi i Bashkimit Evropian, që njihet si plani franko-gjerman, nuk është marrëveshje finale, por është një kornizë apo një marrëveshje

bazike, jopërfundimtare. “Kjo marrëveshje, e cila është e vërtetë se ka paragrafë e fjali të tëra që merren nga modeli i dy Gjermanive, sërish është veçse një marrëveshje bazë, jo marrëveshje ligjërishit e obligueshme, ndërkombëtarisht obliguese çfarë na nevojitet neve”, ka thënë kryeministri Kurti, duke shtuar se: “Duhet

kuptuar se nuk ka pasur mundësi që të vijnë nga Brukseli, Berlina e nga Parisi që të na sjellin marrëveshjen finale. Kjo nuk është e mundshme sepse kjo do shumë procese negociatash të thella e të gjata”.

Emisarët evropianë, emisarët franko-gjermanë, shtoi Kurti, “nuk na kanë sjellë një

dokument në stilin ‘merre ose lëre’”. Ndërkaq sa i përket Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, Kurti ka pohuar se në propozimin franko-gjerman nuk është as parakusht e as në qendër. “Ajo çka i duhet Kosovës është njohja reciproke dhe marrëveshje finale pa njohje reciproke në qendër nuk do të ketë”, ka deklaruar Kurti.



# Tërmeti në Turqi, MPJD: Shtetasit e Kosovës me të cilët është vënë kontakt janë jashtë rrezikut

PRISHTINË, 9 SHKURT - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës (MPJD) ka bërë me dije se shtetasit e Kosovës, me të cilët janë në kontakt dhe që ndodheshin në jug të Turqisë, tashmë janë të sigurt nga tërmetet, ndërkohë numri i viktimave nga kjo fatkeqësi natyrore ka arritur në më shumë se 16 mijë. Ministria, gjithashtu, bën me dije se nuk ka studentë nga Kosova që studiojnë në zonën e prekur nga tërmeti.

Ambasada e Kosovës në Ankara thotë se një familje nga Kosova gjendet në Gaziantep, epiqendër e tërmetit, dhe se është në gjendje të mirë shëndetësore. "Familja është

evakuuar në një sallë sportive për shkak të dëmeve në shtëpinë ku banonte. Ata kanë blerë bileta të autobusit për t'u kthyer në Kosovë", thuhet në njoftimin e MPJD-së.

Një delegacion i Federatës i Mundjes së Kosovës, që ishte në Kahramanmarash, ka shpëtuar pa pasoja dhe është larguar nga zona e prekur nga tërmeti. Po ashtu, një qytetare e Kosovës me shtetësi gjermane, që ndodhej në Kahramanmarash gjatë tërmetit, ka kontaktuar ambasadën dhe është kthyer në Gjermani.

Të martën, më 7 shkurt, një nënë me vajzën e saj katërvjeçare kanë kontaktuar

numrat emergjentë të ambasadës për të kërkuar ndihmë për t'u kthyer në Kosovë, por kanë njoftuar se kanë humbur dokumentet e udhëtimit. "Ambasada e Republikës së Kosovës në Ankara dhe Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Stamboll mbesin në komunikim me shtetasen në fjalë për t'i parë opsionet e udhëtimit të saj për Stamboll dhe më pastaj për në Kosovë", thuhet në njoftim.

Në mbrëmjen e datës 7 shkurt, Ambasada e Kosovës në Ankara është kontaktuar në numrin emergjent edhe nga një shtetas tjetër kosovar nga qyteti Gaziantep. Sipas

MPJD-së, ky qytetar është larguar nga ajo zonë për në Stamboll dhe më pas ka udhëtuar për Prishtinë me fluturim të rregullt.

Në mëngjesin e datës 8 shkurt, ambasada ka marrë njoftimin për një shtetas kosovar që jeton dhe punon në Gaziantep. "Ai dhe familja e tij kanë shpëtuar pa lëndime dhe se me veturën e tyre janë nisur për në Ankara", thotë ministria.

Edhe një shtetase e Kosovës ka arritur me aeroplan nga qyteti Gaziantep në Ankara, ku ekipi i ambasadës e ka pritur dhe i ka siguruar akomodim. "Ambasada e Kosovës në Ankara dhe

Konsullata e Përgjithshme në Stamboll do të vazhdojnë që edhe në ditët e ardhshme, përmes kanaleve zyrtare dhe jozyrtare, të hulumtojnë për shtetas të tjerë që eventualisht mund të jenë në zonat e prekura nga tërmeti", thuhet në njoftim.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka shpallur të mërkurën ditë zie në Kosovë në nderim të viktimave nga tërmeti në Turqi dhe Siri.

Një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës tashmë është në Turqi duke ndihmuar në operacionet e kërkim-shpëtimit që nga 6 shkurti, kur u godit nga tërmetet të fuqishme vdekjeprurëse.



## Kryeprokurori i Shtetit me ekspertët amerikanë të FMCS-së: Rritet numri i rasteve të zgjidhura përmes ndërmjetësimit

PRISHTINË, 9 SHKURT - Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, së bashku me kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe kryeprokurorët e prokurorive themelore të vendit, kanë mbajtur takim të përbashkët me ekspertë amerikanë për ndërmjetësim të FMCS-së, të kryesuar nga Peter Swanson. Gjatë këtij takimi u diskutua për ndërmjetësimin në Kosovë, konkretisht për sfidat e këtij instituti.

Kelmendi i njoftoi ekspertët amerikanë të ndërmjetësimit se në të gjitha prokuroritë e vendit është rritur numri i rasteve të

zgjidhura përmes referimit të tyre në ndërmjetësim. Ai ka theksuar se në secilën prokurori themelore është caktuar nga një zyrtar që është ngarkuar me punë shtesë për ndërmjetësim. Pasi që referimi i rasteve penale në procedurë të ndërmjetësimit nga ana e prokurorëve do të ndikojë në uljen e numrit të rasteve në prokurori, në uljen e numrit të rasteve në gjykata, kursimin e kohës për pjesëmarrësit në procedurë, si dhe uljen e numrit të personave të ndjekur penalisht, u.d. Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, i informoi të pranishmit se do të hartojë një



udhëzues të detyrueshëm për prokurorë për referimin e rasteve në ndërmjetësim. Ky takim u organizua me kërkesë të programit të financuar nga International

Narcotics and Law Enforcement Affairs (INL), Programi i Ndërmjetësimit për Sundimin e Ligjit në Kosovë, implementuar nga Shërbimi Federal i Ndërmjetësimit dhe Pajtitimit

(FMCS) i ShBA-së, të cilët shprehën gatishmërinë e tyre për organizimin e trajnimeve dhe diskutimeve të përbashkëta për prokurorë dhe zyrtarë të ndërmjetësimit nëpër prokuroritë themelore për aplikimin e ndërmjetësimit. Ndërmjetësimi u siguron qytetarëve një alternativë të re për zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve të tyre, pa iu drejtuar procesit gjyqësor, me kosto shumë më të ulët dhe për një kohë shumë më të shkurtër, transparente, ku janë vetë palët që vendosin në marrjen e vendimit, zgjidhjen e çështjes dhe përmirësimin e raporteve.



## Ambasadori Minxhozi viziton Podujevën

PODUJEVË, 9 SHKURT - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemajl Minxhozi. Bulliqi dhe ambasadori Minxhozi kanë diskutuar rreth çështjeve në interes të të dyja palëve, në veçanti kanë biseduar për mundësinë e bashkëpunimit në mes të Podujevës dhe

bashkive të Shqipërisë. “Kemi mundësi dhe potencial të jashtëzakonshëm të bashkëpunimit në shumë sfera. Na mbetet që vullnetin tonë ta konkretizojmë me bashkëpunime konkrete në dobi të qytetarëve të të dyja anëve”, ka thënë kryetari Bulliqi.

Kryetari Bulliqi dhe ambasadori Minxhozi u

pajtuar që të bashkëpunojnë për realizimin e projekteve të përbashkëta, veçmas në fushën e arsimit, kulturës, sportit, ekonomisë dhe bujqësisë. Ndërsa në fund të takimit kryetari Bulliqi bashkë me ambasadorin Minxhozi e bënë një ecje përgjatë bulevardit të qytetit duke e njoftuar për veçoritë e qytetit të Podujevës.



## Molliqaj viziton krerët e UÇK-së në Hagë: Emri i UÇK-së nuk mund të jetë nën akuzë

PRISHTINË, 9 SHKURT - Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, po qëndron për vizitë në Hagë, me ç'rast ka takuar krerët e UÇK-së të cilët po mbahen në paraburgim nga Gjykata Speciale. “Bashkë me Qëndronin dhe Kujtimin për tri ditë rresht po qëndrojmë në Hagë. Udhëtimi në Hagë qenka edhe udhëtim në kohë. Siç duket koha historike nuk e ndjek lëvizjen e njëtrajtshme e të kurditur të akrepave. Përjetuam diçka që e kemi ditur si të kryer. Forcat që tërheqin nga mbrapa nuk e pranojnë ngadhënjimin e të vërtetës. Haga, të dashur miq, është Kosova alternative. Haga është Kosova që mund ta kishim pa UÇK-në. Të mbyllur me dyer hekuri. I pamë dhe i takuam të gjithë. Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin, Sali Mustafën, Pjetër

Shalën, Nasim Haradinajn dhe Hysni Gucatin. Respektivisht aty ishte politika e luftës; informimi e fjala e saj; zbulimi e guerilja; disiplina e mbikëqyrja”, ka thënë Molliqaj.

Ai ka theksuar se bisedat e tyre janë endur, janë përzier e janë kryqëzuar. “Disa prej tyre nuk i kishim njohur personalisht. Nga atje, Prishtina e vitit 2023 është shumë larg. Distanca është sidomos kohore. Aty jetohet në vitet 1997-1999. Aty gjykohej UÇK-ja. Aty paguhet ende çmimi i lirisë. Do të bëjmë gjithçka që mundemi për ta ndryshuar Ligjin për Dhomat e Specializuara. Emri i UÇK-së nuk mund të jetë nën akuzë. Kosova duhet të bashkohet për drejtësi. Për juristët e ardhshëm, padrejtësia në Hagë do të bëhet shembull, ilustrim unik për shkeljen e të drejtave”, ka deklaruar Molliqaj.



## Komuna e Skenderajt tregon vlerën e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet



SKENDERAJ, 9 SHKURT - Komuna e Skenderajt ka njoftuar të enjten se 11 milionë e 815 mijë e 277 euro e 69 centë është vlera e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet e 19 janarit të këtij viti.

Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Inovacion dhe Turizëm në këtë komunë, Besarta Meha-Ademi, tha se vlerësimi i dëmeve është bërë nga Kuvendi Komunal në një seancë të jashtëzakonshme. Siç bëri me dije ajo, dëmet janë

shkaktuar në ekonomitë familjare, biznese, vetura, bujqësi, arsim, institucione dhe infrastrukturë publike. “Kuvendi Komunal i Skenderajt ka mbajtur sot seancë të jashtëzakonshme mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e 19 janarit të këtij viti. Dëmi i shkaktuar nga vërshimet është 11 815 277.69 euro (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e nëntë

centë), në ekonomitë familjare, biznese, vetura, bujqësi, arsim, institucione publike dhe infrastrukturë publike”, ka shkruar Meha-Ademi.

Më tutje, ajo bëri me dije se, pas diskutimeve në këtë pikë dhe sqarimeve, raporti është miratuar me shumicë votash. “Pas këtij procesi, raporti përfundimtar do t'i dërgohet nivelit qendror për përkrahje financiare për kompensimin e dëmeve të shkaktuara”, ka thënë Meha-Ademi.

## Haxhiu për miratimin e Byrosë: Përmbushëm një zotim shtyllë të qeverisë Kurti

PRISHTINË, 9 SHKURT - Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka falënderuar deputetët të cilët të enjten miratuan në lexim të dytë Byronë Shtetërore për Verifikimin e Pasurisë së Pajustificueshme. “Falënderoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që e miratuan në lexim të dytë

Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Opinionet e Komisionit të Venecias janë garanci e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së Byrosë. Vetë ky institucion është garanci e vendosjes së drejtësisë për luftimin e intensifikuar të korrupsionit

zyrtar duke i konfiskuar të mirat e përfituara paligjshëm nga të gjithë keqpërdoruesit e fondeve dhe pasurisë publike”, ka shkruar Haxhiu në “Facebook”, duke i falënderuar të gjithë aktorët e përfshirë në përgatitjen e këtij projektligji që shënon përmbushjen e një zotimi shtyllë të qeverisë Kurti.





# Firmoset marrëveshja 38 milionë euroshe për rehabilitimin e rrjetit hekurudhor në Kosovë

PRISHTINË, 9 SHKURT - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe udhëheqësi i Operacioneve të Bankës Evropiane për Investime për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, Matteo Rivellini, kanë nënshkruar të enjten marrëveshjen financiare të financimit shtesë për rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10 në Kosovë.

Marrëveshja në vlerë prej 38 milionë eurosh synon rehabilitimin e 139 km të linjës hekurudhore, përkatesisht në sinjalistikë dhe telekomunikacion. Ky projekt pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në rritjen e shpejtësisë së udhëtimit dhe ngritjen e kapaciteteve për pasagjerë dhe mallra. Gjithashtu, investimet në linjën hekurudhore pritet të çojnë në një zhvendosje modale nga transporti rrugor

në atë hekurudhor si dhe të kontribuojnë në ndërlidhjen dhe integrimin e transportit rajonal në Korridorin Orient/Lindje-Mesdhe.

Projekti veçse ka financim të siguar, në vlerë mbi 137 milionë euro, nga të cilat rreth 56 milionë janë grant nga Korniza Investive e Ballkanit Perëndimor, ndërsa kjo marrëveshje e ngrit financimin e siguar për këtë projekt në mbi 175 milionë euro.

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje ministrit Murati ka thënë se rruga hekurudhore 10 është një nga linjat hekurudhore më të rëndësishme që lidh Kosovën me vendet e tjera dhe rehabilitimi i saj mbetet një prioritet i kahershëm. "Marrëveshja që ne po nënshkruajmë zyrtarisht sot është e një rëndësie të madhe për të siguar që ne të jemi të lidhur me partnerët



tanë tregtarë dhe për ta siguar lëvizshmërinë midis vendit tonë dhe rajonit", ka thënë Murati.

Në anën e tij, Rivellini ka

shprehur përkushtimin e BEI-së për promovimin e integritit rajonal, duke thënë se "krijimi i infrastrukturës moderne, të qëndrueshme

dhe efikase të transportit, është një parakusht për marrëdhënie më të forta ekonomike dhe kushte më të mira jetese".

## Deputetja e LDK-së: Skandal në AKP, janë ekzekutuar 3.5 milionë euro me urdhër të një gjykate që nuk është kompetente



PRISHTINË, 9 SHKURT - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, të enjten në seancën e Kuvendit të Kosovës ka folur për, siç ka thënë, një skandal në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ku, sipas saj, më 30 dhjetor të vitit 2022 brenda tri orëve me urdhër të një gjykate, e cila nuk është kompetente, janë ekzekutuar 3.5 milionë euro nga llogaria e "Mirëbesimit".

Bajrami para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ka thënë se për çështje të privatizimit përgjegjëse është vetëm Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. "Bëhet fjalë për një skandal 3.5 milionë euro në Agjencinë Kosovare të Privatizimit", ka deklaruar Bajrami në Kuvend, duke shtuar se ajo çfarë dimë deri më tani për rastin "është se më 30 dhjetor të vitit 2022, brenda tri orëve, me urdhër të një gjykate e cila nuk është

kompetente, janë ekzekutuar 3.5 milionë euro nga llogaria e 'Mirëbesimit', fonde të AKP-së që ruhen në Bankën Qendrore".

Ish-ministrja e Financave thotë se përmbaruesit kanë bërë këto vendime kundërligjore pasi, sipas saj, për çështje të privatizimit përgjegjëse është vetëm Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. "Këto 3.5 milionë euro janë ekzekutuar me urdhër të gjykatave të tjera. Ne deri më tani kemi parë që ministrja e Drejtësisë e ka suspenduar një përmbarues privat me kërkesë të AKP-së për këtë rast. Në bazë të informative që kemi, AKP ka reaguar dhe prokuroria ka arritur të bllokojë 2.1 milionë euro", ka thënë Bajrami.

Deputetja opozitare thotë se fondet e AKP-së që janë disbursuar në llogari të gjykatësve dhe prokurorëve janë 1.4 milion euro.

## Miratohet në lexim të dytë Projektligji për Byronë Shtetërore

PRISHTINË, 9 SHKURT - Është miratuar në lexim të dytë Projektligji për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. Miratimi i këtij projektligji u bë në seancën e së enjtes në Kuvendin e Kosovës, ku 66 deputetë votuan

për, asnjë kundër dhe asnjë nuk abstenoj.

Po ashtu, deputetët votuan edhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe zhvendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive

ekzekutive.

Në lidhje me këtë projektligj, 61 vota ishin për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, ku rrjedhimisht u ngarkua komisioni i përhershëm dhe ata funksionalë që ta trajtojnë këtë projektligj dhe ta sjellin atë në lexim të dytë.





# Matematika: E kemi zbuluar apo shpikur?



Në traktatin e vitit 1623 “Il Saggiatore”, fizikanti, matematikani dhe filozofi italian Galileo Galilei, formuloi përmes një metafore një nga mendimet që konsiderohet ende sot si më i rëndësishmi në historinë e evolucionit të konceptit të shkencës dhe metodës shkencore. Ai shkroi se “filozofia natyrore është shkruar në këtë libër të madh, i cili është vazhdimisht i hapur para syve tanë”, dhe se ai libër “është i shkruar në gjuhën e matematikës, dhe personazhet janë trekëndësha, rrathë dhe figura të tjera gjeometrike”.

Metafora e “librit të natyrës”, është rimarrë kohët e fundit nga shumë mendimtarë të tjerë, midis tyre fizikanti amerikan Riçard Fejnman, që në librin e tij “Ligji fizik” shkroi se për të njohur dhe vlerësuar natyrën “është e nevojshme të kuptohet gjuha që flet ajo”, pra matematika.

Reflektime të tilla mbi marrëdhënien e thellë dhe ndërvarësinë midis matematikës dhe natyrës, kanë originë shumë të lashtë në traditën e mendimit filozofik perëndimor dhe në historinë e shkencës. Hipoteza se matematika është gjuha e Universit, dhe se numrat janë entitete reale dhe jo thjesht sa për paraqitje, gjurmohet tradicionalisht që në shekullin V para Krishtit, dhe në veçanti në shkollën e Pitagorës në Greqinë klasike.

Për Pitagorianët, realiteti ishte në thelb matematikor. Ata besonin se ai përbëhej nga objekte matematikore, ashtu si materia që përbëhet nga atomet. Numrat ishin njëkohësisht njësi reale dhe parime universale, dhe monada (nga greqishtja μόνος, monos, unike, një), ishte parimi i parë nga i cili buronin të gjithë numrat dhe elementët e tjerë të Universit.

Për Platonin, numrat dhe format gjeometrike ishin entitete konkrete dhe reale, të pavarura nga ekzistenca e subjektit që i përjeton dhe i njeh. Dhe pavarësisht se ka kaluar nëpër ripërpunime të ndryshme, kjo ide është mbështetur nga shumë matematikanë përgjatë shekujve.

Në shekullin XX, tradita pitagorao-platonike u ringjall nga matematikani zviceran Pol Bernais dhe nga matematikani gjerman Georg Kantor, i konsideruar si themeluesi i teorisë së grupeve, dhe një nga teoricienët e parë të pafundësisë si diçka e matshme.

Sipas një koncepti të ripunuar në mënyra të ndryshme, por që ende ndahet nga eksponentët e të ashtuquajturit platonizëm matematikor, matematikanët i izolojnë objektet e natyrës duke i përcaktuar vetitë e tyre. Por fakt është se këto objekte ekzistojnë dhe kanë stabilitetin e tyre pavarësisht nga qeniet njerëzore.

Në këtë kuptim, matematika do të ishte një “zbulim” jo shumë i

ndryshëm nga ai që zakonisht i atribuohet eksploruesve evropianë që arritën në Amerikë në fundin e shekullit XV. Ata e “zbuluan” atë në kuptimin që zbuluan diçka që ekzistonte tashmë. Pra e eksploran atë, dhe duke lëvizur nëpër ato hapësira u dhanë emra luleve, bimëve dhe objekteve të tjera që vëzhguan.

Një nga mbështetësit më të cituar të teorisë së zbulimit të matematikës ishte matematikani austriak Kurt Gödel, sipas të cilit klasat dhe konceptet e matematikës mund të konceptohen si objekte reale. Për të, klasat e kuptuara si “shumësi gjërash”, dhe vetitë dhe marrëdhëniet midis këtyre gjërave, ekzistojnë pavarësisht nga përkufizimet tona.

Një argument i përdorur shpesh në këtë debat, dhe për të mbështetur idenë se matematika është gjuha e natyrës, është prania e strukturave dhe rregullive të veçanta tek vetë natyra. Një shembull i shpeshtë është ai i fraktaleve, entitete gjeometrike të pajisura me veti të caktuara.

Lakra romake është një nga shembujt më të përmendur dhe më të njohur, megjithëse rregullsia e fraktaleve është e përafërt dhe nuk vazhdon pafundësisht. Struktura të tjera të rëndësishme vijnë nga mbretëria e kafshëve. Për shembull, dihet forma gjashtëkëndore e hojeve të ndërtuara nga bletët punëtore në koshere për të depozituar mjaltin dhe polenin.

Një nga hipotezat e formuluar për të shpjeguar këtë strukturë vertikale është se gjashtëkëndëshi i rregullt – me 6 brinjë me gjatësi të barabartë, dhe 6 kënde me gjerësi të barabartë – është figura gjeometrike e cila lejon përpunimin e një sipërfaqeje të sheshtë në mënyrën më efikase të mundshme.

Sipas kësaj hipoteze, hoja përbëhet nga figura gjashtëkëndore sepse bletët përpiqen të ruajnë burimet duke minimizuar sasinë e dyllit të përdorur për ta ndërtuar atë. Një veprim i ndikuar nga evolucionit, siç do të vërente edhe natyralisti anglez Çarls Darwin. Në fakt çdo lloj strukture tjetër do të kishte një raport më pak të favorshëm midis sipërfaqes së përgjithshme të sipërfaqes së mbuluar.

Bletët duhej të bënin një përpjekje më të madhe, nëse do të përdornin shumëkëndësha të ndryshëm nga gjashtëkëndëshi (për shembull, trekëndësha ose katrorë barabrinjës, të cilët do të lejonin gjithashtu që sipërfaqja të mbulohej në mënyrë të njëtrajtshme).

Ndërkohë matematikanët të tjerë mendojnë se matematika është një shpikje njerëzore. Sipas kësaj perspektive, objektet matematikore nuk janë objekte që ekzistojnë diku në pritje për t’u zbuluar. Përkundrazi, ato janë koncepte që nuk ekzistojnë derisa dikush t’i përcaktojë, t’i “krijojë” ato, me ose pa synimin për ta kuptuar

Universin.

Ideja që qëndron pas hipotezës se matematika është një shpikje, është se të gjitha objektet dhe konceptet matematikore, nga parabolat tek rrënjët katrore, nuk janë të vërteta në kuptimin në të cilin themi se është e vërtetë që zjarri digjet. Sipas një qasjeje të njohur si formalizëm, teoritë matematikore thuhet se janë pjesë e një “loje”, me rregulla të vendosura nga njerëzit, ashtu siç është rregulli i vendosur, sipas të cilit në lojën e shahut oficeri mund të lëvizë vetëm diagonalisht.

Ndër mbështetësit kryesorë të kësaj qasjeje, përmendet shpesh matematikani gjerman David Hilbert, i cili jetoi midis shekujve XIX–XX, në një periudhë historike të karakterizuar ndër të tjera nga nxitja për ta kuptuar matematikën si një ndërtim logjik.

Për Hilbert, sado që rrjedhin nga fizika dhe përvoja intuitive e hapësirës, të gjitha teoritë matematikore duhet të ishin reduktuar në sisteme formale. Ndërkohë sot ka përpjekje që matematika të konsiderohet në të njëjtën kohë si shpikje dhe zbulim. Sipas kësaj qasjeje

të tretë, matematika është një shpikje në masën që është një mënyrë për t’i dhënë formë materies, por edhe një zbulim në masën që materia i jep substancë matematikës.

*Marrë me shkurtime nga Il Post – bota.al*



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



Veton Zymberi, redaktor i sportit

## KB Peja largon katër basketbollistë, transferon dy

**PEJË, 9 SHKURT (ER)** - Skuadrat e basketbollit në Superligën e Kosovës po bëjnë ndryshime. Në 24 orët e fundit mjaft aktive është treguar skuadra pejane e cila ka transferuar dy basketbollistë, kurse me katër të tjerë e ka përfunduar bashkëpunimin. Klubi nga Peja ka njoftuar se nga foleja e "shqiponjave" janë larguar: Rodney Purvis, Isiah Umrigar, Ivan Koljeviq dhe Khaliq Spicer. "Klubi ju dëshiron çdo të mirë lojtarëve në vazhdim dhe i falënderon shumë për kontributin e tyre në klub", thuhet në njoftimin e klubit pejan.

Ky klub nuk ka vonuar shumë dhe e ka zyrtarizuar transferimin e basketbollistit Larry Thomas derisa së shpejti

pritet të transferojnë edhe lojtarë të tjerë. Basketbollisti Thomas, që luan në pozitën e organizatorit të lojës, ka një përvojë në Islandë, Latvi, Meksikë dhe Belgjikë.

Transferimi tjetër i skuadrës së Pejës është Devoe Joseph. Ky i fundit ka një përvojë të madhe, pasi ka luajtur në ligën elitare të Ukrainës, Spanjës, Turqisë dhe disa shteteve të tjera. "KB Peja ju njofton se ka nënshkruar kontratë me lojtarin kanadez Devoe Joseph. Lojtari i pozitës dy ka një përvojë në liga elite të Ukrainës, Spanjës, Turqisë, Francës, Izraelit, Finlandës dhe, së fundi, ishte pjesë e ekipit Enea Zastal të Polonisë. Ai i bashkohet ekipit dhe do të na ndihmojë në vazhdim të kampionatit", ka njoftuar KB Peja.



## Ademi: Kosovare Asllani më 17 shkurt do të vijë në Kosovë

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka konfirmuar se Kosovare Asllani do të vijë në Kosovë më 17 shkurt, datë kur vendi ynë mbush 15 vjet të pavarësisë. Numri i FFK-së është takuar me ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund. Gjatë këtij takimi Ademi ka njoftuar se është diskutuar për bashkëpunimin e ndërsjellë si dhe ka konfirmuar se futbollistja nga Kosova me famë botërore që përfaqëson Suedinë, Kosovare Asllani, do të vijë në Kosovë për 17 shkurt si ambasadore e shpresës së mirë të UNICEF-it. Asllani do të qëndrojë në vend për disa orë sipas agjendës dhe protokollit të UNICEF-it. "Me kënaqësi prita në takim ambasadorin e Suedisë, Jonas Westerlund, në selinë e FFK-së. Gjatë këtij takimi




diskutuam për bashkëpunimin e ndërsjellë si dhe për ardhjen e futbollistes me famë botërore, Kosovare Asllani, me misionin të UNICEF-it. Futbollistja me prejardhje nga Kosova është ambasadore e shpresës së mirë të UNICEF-it dhe do të jetë në Kosovë më 17 shkurt. UNICEF-i, bashkë me Ambasadën

Suedeze dhe FFK-në do të organizojnë pritjen për futbollisten e Kombëtares suedeze, e cila luan për skuadrën e Milanit dhe më parë ishte pjesë e Real Madridit. Ajo do të qëndrojë në Kosovë për disa orë sipas agjendës dhe protokollit të UNICEF-it", ka shkruar Ademi në "Facebook".

## Fitojnë Trepça dhe Prishtina

**GJAKOVË, 9 SHKURT** - Prishtina ka arritur fitore në udhëtim në Gjakovë, duke fituar ndaj Vëllaznimit me rezultat 47:94 (8:24, 13:24, 16:27, 10:19). Vajzat nga Prishtina dominuan gjatë tërë ndeshjes, kështu duke shënuar fitoren e 13, kurse kanë vetëm tri humbje. Në anën tjetër Vëllaznimi ka vetëm një fitore nga 16 ndeshje të zhvilluara. Më e mira te Prishtina ishte Diellza Dekaj, e cila kontribuoi me 18 pikë, pesë kërcime dhe

një asistim. Fitore në kuadër të xhiros së 16 shënoi edhe Trepça ndaj vajzave United Basketball me rezultat 33:39 (11:10, 11:5, 5:15, 6:9). Ndeshjen e nisën më mirë vajzat nga Gjilani, por periudha e tretë e riktheu Trepçën duke e regjistruar kështu fitoren e pestë, një më shumë se United Basketball. Te Trepça u dallua Marshanique Hall me tetë pikë, nëntë kërcime dhe pesë asistime.



## Federata e Boksit, e gatshme për turneun tradicional 'Pavarësia'

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Federata e Boksit e Kosovës ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e turneut tradicional ndërkombëtar, i 15-

ti me radhë, "Pavarësia", më 12 shkurt 2023, në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Pjesëmarrës do të janë boksierët nga Zvicra, Sllovenia,

Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova. Duelet fillojnë nga ora 12:00. Gjyqtarë do të jenë: Agim Shala, Agim Tahiraj, Marigona Beadini, Fadil Bekteshi, Visar

Ibrahimi, Granit Qorri, Luan Krasniqi. Delegat do të jetë Sylejman Voca, kurse mjekë kujdestarë Agron Kamberi, Artan Lushaj.





## Trajneri i Turqisë: Ndhmoni viktimat e tërmetit, ja se si mund ta bëni!

**STAMBOLL, 9 SHKURT** - Trajneri i Kombëtares së Turqisë, Stefan Kuntz, u ka kërkuar ndjekësve të tij në rrjetet sociale e jo vetëm që t'i ndihmojnë sadopak viktimat e tërmetit që deri më tani ka marrë mbi 10 mijë jetë njerëzish, ndërsa mijëra të tjerë janë ende nën rrënoja. Në një postim në

rrjetet sociale gjermani kërkon që kush ka mundësi të dhurojë para për t'i ndihmuar personat e prekur. "Të dashur miq, fansa dhe ndjekës. Me siguri keni dëgjuar për tërmetin në Turqi. Mijëra njerëz kanë humbur nënën, babanë, gjyshërit, xhaxhallarët, fëmijët, vëllezërit. Dhe shumë të tjerë janë

varrosur nën rrënojat e shtëpive të shkatërruara. Më shumë se 10 qytete janë prekur, më shumë se 13 milionë njerëz jetojnë në këtë zonë. Shumë miq më kanë pyetur: si mund të ndihmojmë ne, kemi filluar edhe një fushatë për mbledhjen e fondeve në të cilën po marrim pjesë lojtarët e kombëtares

sonë, familja ime dhe unë. Ne sigurohemi që paratë të transferohen në llogarinë e AFAD-it (Ekuivalenti i Mbrojtjes Civile Turke), prandaj është 100 % e garantuar që paratë të arrijnë në zonat ku nevojiten. Detajet i gjeni pas kësaj videoje. Ju lutemi shpërndajeni këtë video sa më shumë që të jetë e



mundur që më shumë njerëz të mund të ndihmojnë. Nuk ka rëndësi nëse je gjerman, turk apo tjetër", ka thënë Kuntz.

## Rikthehet në skenë Superliga e Evropës

**MADRID, 9 SHKURT** - Me vendimin e fundit kundër UEFA-s, klubet iniciuese për krijimin e Superligës Evropiane po riorganizohen për të paraqitur një projekt më ambicioz dhe që të miratohet nga të gjithë. Real Madridi, Barcelona dhe Juventus vazhdojnë të këmbëngulin në krijimin e kompeticionit të ri dhe raportohet se kanë kontaktuar më shumë se 50 klube që të bëhen pjesë e kësaj lige kontinentale. Një version i ri është ngritur, në të cilin do të bëjë pjesë 60 deri në 80 klube, me jo të njëjtit pjesëtarë dhe me një minimum prej 14 ndeshjesh për skuadër në sezon dhe gjithashtu disa divizione. Ende nuk ka detaje se si do të funksionojë kjo Superligë, sepse ende nuk dihet



nëse klubet e propozuara kanë pranuar ose jo të jenë pjesë e këtij formati. Kësaj here UEFA nuk mund të bëhet pengesë, pasi e pengon vendimi i gjykatës. Gjithsesi, organizmi i futbollit

evropian po përdor disa krerë federatash, ku spanjollli Javier Tebas pohoi sërish se do të bëjë të pamundurën që klubet e La Ligës të mos jenë pjesë e Superligës Evropiane.

## Bostoni mposhti rivalët e Philadelphias

**BOSTON, 9 SHKURT** - Bostoni mbetet ende skuadra më e mirë e këtij sezoni në NBA pas fitores me rezultat 106-99 ndaj rivalëve të Philadelphias. Embiid me 28 pikë e Hardeni me 26 u përpoqën t'i japin fitoren skuadrës së tyre, por pa sukses. Për Celticsin, White e Brogdon realizuan nga 19 pikë secili, por vendimtare ishin 41 pikët që erdhën nga lojtarët e stolit. Debuton me fitore Kyrie Irvingu te Dallasi, që mundi me rezultat 110-104 Clippersin. Ish-



lojtari i Netsit ishte protagonist me 24 pikë, shënuesi më i mirë për Mavericksin, ku mungoi Donçiqi. Skuadra kampione e Golden States u mund me rezultat 125-122 nga Portlandi, ku u dallua Damian Lillard me një "triple double" (33 pikë, 10 rebounde e 11 asistime). Fitoi edhe Miami, që mundi me rezultat 116-111 Indianan,

ndeshje ku dallimin e bëri Adebayo me 38 pikë. Një fitore të thellë arriti jashtë fushës ekipi i Minnesotas, që mposhti me shifrat 143-118 Utah Jazzin, me dyshen Edwards-Nowell, që së bashku realizuan 61 pikë. Ekipi i Torontos, falë 37 pikëve e 10 reboundeve të Siakamit, mundi San Antonion (112-98).

### REZULTATET

<b>Cleveland - Detroit</b>	<b>113-85</b>
<b>Washington - Charlotte</b>	<b>118-104</b>
<b>Boston - Philadelphia</b>	<b>106-99</b>
<b>Miami - Indiana</b>	<b>116-111</b>
<b>Toronto - San Antonio</b>	<b>112-98</b>
<b>Houston - Sacramento</b>	<b>128-130</b>
<b>Utah Jazz - Minnesota</b>	<b>118-143</b>
<b>Clippers - Dallas</b>	<b>104-110</b>
<b>Portland - Golden State</b>	<b>125-122</b>

### SHKURT

#### Galatasaray e dëshiron Berishën

Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, mund të largohet nga futbollit italian pas një kohe të gjatë. Ai mund të transferohet në futbollin turk. Mediet italiane raportojnë se portieri kuqezi ka marrë ofertë nga skuadra e Galatasarayt. Afati kalimtar në Turqi është zgatur për dhjetë ditë për shkak të tërmetit, prandaj gjasat që Berisha të transferohet atje janë të mëdha. Portieri nga Kosova e ka humbur vendin e titullarit në Torino, derisa Galatasaray e dëshiron në vend të portierit Muslera, i cili ka pësuar një lëndim.

#### Hamiltoni: Jam i uritur për fitore

Me datat 23-25 shkurt në Bahrein do të zhvillohen testet e vetme dimërore në Formula 1 dhe skuadrat janë duke kryer përgatitjet e fundit në prag të sezonit të ri. Disa prej makinave janë prezantuar, ndërkohë që ende nuk e ka bërë këtë gjë Mercedesi. Në prag që makina gjermane t'i zbulojë sekretet e saj, piloti britanik Lewis Hamilton, 7 herë kampion bote në Formula 1, ka bërë një deklaratë të fortë. Përmes një postimi në rrjetet sociale ai komenton sezonin e ri: "I uritur atëherë, i uritur për fitore jam edhe tani". Një deklaratë që është si një kushtrim lufte për britanikun, që vjet nuk korri asnjë fitore, ndaj synon që këtë vit të triumfojë me Mercedes. Palët kanë nisur edhe bisedimet për ta rinovuar kontratën e Lewis Hamiltonit e cila skadon në fund të këtij sezoni.

#### Juve i shtohet garës për Kanten

N'Golo Kante, pas problemeve të vazhdueshme me lëndimet, vështirë se do të jetë pjesë e Chelseat edhe pas përfundimit të kontratës në muajin qershor. Skuadra angleze nuk ka ofruar rinovimin, por ofertat për mesfushorin francez nuk po mungojnë. Fillimisht Barcelona ka shprehur interesim, kurse tash të njëjtën gjë e ka bërë edhe Juventus. Në avantazh duket klubi spanjoll që ka ofruar kontratë katërvjeçare, kundrejt "Zonjës së Vjetër" që ofroi vetëm dy.

#### Zaniolo edhe zyrtarisht në Galatasaray

Nicolo Zaniolo është lojtar i ri i Galatasarayt. Njoftimi zyrtar ka ardhur nga faqja e klubit turk, por edhe nga Roma. Sulmuesi italian përjetoi disa ditë jo shumë të qeta, por më në fund arriti të ndryshonte destinacion. Zaniolo do të jetë në ekip me lojtarë si Mertens apo Icardi. "AS Roma njofton se ka arritur një marrëveshje me Galatasarayn për transferimin e Nicolo Zaniolos. Sulmuesi kalon në mënyrë të përhershme te skuadra turke. Zaniolo mbërriti në kryeqytet në verën e vitit 2018, duke grumbulluar 128 ndeshje dhe 24 gola me fanellën e 'Giallorossit', shkruhet në faqen zyrtare të klubit kryeqytetas.

## Alvesi ndryshon deklaratën për herë të katërt në rastin për përdhunim

Përkeqësohet çdo ditë e më shumë situata me Dani Alvesin, i cili ndodhet në burg dhe i akuzuar për përdhunim. I përballur me shumë gjetje dhe prova të reja, Alvesi ka ndryshuar disa herë deklaratën e tij, gjë që ndikon keq në

gjendjen e tij dhe tani ai e ka ndryshuar deklaratën për herë të katërt. Ndonëse më herët ka mohuar se ka pasur marrëdhënie, tani e ka pranuar se ka pasur marrëdhënie seksuale me vajzën që e akuzoi. Alvesi

dyshohet se në tri deklaratat e mëparshme ka mohuar se ka pasur depërtim për ta fshehur tradhtinë ndaj gruas së tij Joana Sanz, e cila së fundmi e ka vizituar në burg, duke mohuar mediet që kanë njoftuar se ajo do të

divorcohet. Alvesi në deklaratën e tij të parë ka thënë se nuk e njeh gruan që e ka akuzuar për përdhunim, më pas ka thënë se ka pasur vetëm prekje dhe tani ka ndryshuar tërësisht deklaratën. Prandaj, në rast se shpallet fajtor, do të

dënohet me 12 vjet burg. Ngjarja dyshohet se ka ndodhur më 31 dhjetor të vitit të kaluar, kur Dani Alves shkoi me miqtë në një klub nate në Barcelonë. Të nesërmen ai udhëtoi për në Meksikë, ku luajti për Pumasit e tij, por shpejt u arrestua.





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 27.2 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2023 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 177 të datës 08.02.2023 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

### KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

<b>1. Pozita:</b>	<b>Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri</b>
<b>Numri i referencës:</b>	AJAFP/ZKA/01-02/23
<b>Grada:</b>	ZKA-A8
<b>Numri i pozitave:</b>	Dy (2)
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	Me kohë të pacaktuar

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
- Indeksimi i letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri me formatin dhe kërkesat e përcaktuara nga metodologjia, që t'i mundësoj UE një rishikim me të lehtë;
- Përfundimi me kohë i letrave të punës, memove të komponentëve dhe të gjitha detyrave sipas kërkesave të UE për t'i aritur planet kohore të aprovuar nga menaxhmenti;
- Ofron bashkëpunim dhe informata të sakta për Ekipin e auditimit, departamentin e tij dhe me të gjithë sektorët dhe departamentet e tjerë në kuadër të ZKA-së;
- Ndihmon stafin tjetër të ekipit dhe të departamentit, rreth punëve audituese, për përdorim të teknologjisë informative, ofron përkrahje UE dhe të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ekipit dhe të departamentit;
- Komunikim të mirë me anëtarët e ekipit me UE, DD, stafin e ZKA dhe me stafin e entiteteve gjatë auditimit;
- Të ruajë dhe azhurnoj njohtitë profesionale dhe teknike dhe të tregoj gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat e dakorduara me UE dhe DD gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Tregoj integritet të lartë dhe vepron në pajtim me Kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale që mund të kërkojnë nga UE dhe DD i/e tij.

#### Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike;
- Certifikatë në njërën nga skemat e certifikimit si teknik kontabiliteti dhe asistent-auditor i sektorit publik.

#### Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathtësi në organizim të punës dhe përbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

#### Informata të përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për pozitat e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

#### Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

#### Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 25.02.2023 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 ZA o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj kancelariji revizije (objavljeno u Službenom listu 16.09.2021), vezano za Član 27.2 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu zapošljavanja za 2023. godinu, kao i Odluci Generalne revizorke sa Br. 177 datuma 08.02.2023 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije objavljuje:

### KONKURS za popunjavanje slobodnih radnih mesta

<b>1. Pozicija:</b>	<b>Junior Revizor za finansijsku reviziju i reviziju usklađenosti</b>
<b>Broj reference:</b>	AJAFP/ZKA/01-02/23
<b>Koeficijent:</b>	ZKA-A8
<b>Broj pozicija:</b>	Dva (2)
<b>Trajanje imenovanja:</b>	Na neodređeno vreme

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže VT-u u prikupljanju preliminarnih informacija o revizijama u kojima se angažuje, u pripremi revizorskih dosijea i obavlja druge poslove vezanih za reviziju;
- Jasno pisanje u popunjavanju revizorskih radnih dokumenata o adresiranim pitanjima iu skladu sa standardima NKR-a i njihovo blagovremeno dostavljanje VT-u;
- Indeksiranje radnih dokumenata o temama (uzorcima) i revidiranim oblastima i svih dokumenata (uključujući one primljene od subjekata) koje treba da budu u skladu sa formatom i zahtevima navedenim u metodologiji, kako bi se VT-u omogućila lakša revizija;
- Blagovremeno popunjavanje radnih dokumenata, memorandumima o komponentama i svih zadataka u skladu sa zahtevima VT-a da bi se postigli rokovi koje je odobrio menadžment;
- Pruža saradnju i tačne informacije Timu za reviziju, njegovom departmanu i svim drugim sektorima i departmanima u okviru NKR-a;
- Pomaže drugom osoblju tima i departmana, oko revizorskog rada, za korišćenje informacionih tehnologija, pruža podršku VT-u i odgovoran je u sprovođenju zadataka za postizanje objektivna tima i departmana;
- Dobra komunikacija sa članovima tima sa osobljem VT-em, DD-em, NKR-om i osobljem subjekata tokom revizije;
- Održavati i ažurirati stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT-em i DD-em tokom procene učinka za prethodnu godinu, kao i za pohađanje obuka koje organizuje NKR u vezi sa kontinuiranim profesionalnim usavršavanjem i obrazovanjem;
- Pokazuje visok integritet i poštuje Kodeks etike i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i van NKR-a;
- Obavlja i druge profesionalne zadatke koje se mogu zahtevati od VT-a i DD-a.

#### Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijama ili javnoj upravi;
- Sertifikat u jednoj od šema sertifikacije kao računovodstveni tehničar i pomoćnik-revizor u javnom sektoru.

#### Potrebne veštine:

- Poznavanje polja revizije;
- Veštine u organizaciji rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji važe za Nacionalnu kancelariju revizije;
- Poznavanje o efektivnom nadzoru profesionalnog rada;
- Veštine da predstavlja i štiti interese institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikativne veštine u timu;
- Dobre međuljudske veštine.

#### Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

#### Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu

#### Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za apliciranje;
- kopiju lične karte Republike Kosova;
- dokaze o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, zadnji rok za podnošenje dokumentacije 25.02.2023 godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

MEKA  
HALAL FOOD

gluten  
free



cilësi e garantuar

pa konservues